



# Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

## RrGGK dënon portretizimin e grave, vajzave dhe fëmijëve nga mediat online në Kosovë

8 marsi, Dita Ndërkombëtare e Gruas, shërben për të kujtuar përpjekjet për barazi, paqe dhe drejtësi, ditë kjo kur gratë janë vlerësuar për arritjet e tyre pa marrë parasysh ndarjet, qoftë kombëtare, etnike, gjuhësore, kulturore, ekonomike apo politike. Është një rast për të shikuar prapa në sfidat e kaluara dhe arritjet, dhe më e rëndësishmja, për të vazhduar përpara.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) mu në këtë ditë përmes kësaj letre dënon portretizimin e grave, vajzave dhe fëmijëve në disa media online.

Në vend se mediat të kontribuojnë në rritjen e vetëdijës së qytetarëve për barazinë gjinore, ato bëjnë të kundërtën duke publikuar shkrime e video të cilat shkelin [Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale e Audiovizuale në Republikën e Kosovës](#) dhe poashtu [Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 2004/2 15.2](#), i cili “ndalon emetimin e programeve, botimin dhe publikimin e materialeve dhe informatave si dhe shpërndarjen e informatave në formën elektronike mbi baza të diskriminimit gjinor.” Poashtu, neni [15.3](#), i këtij ligji, “ndalohet shfaqjen publike dhe paraqitjen e çdo individi në mënyrë ofenduese, nënçmuese apo poshtëruese përsa i përket gjinisë dhe orientimit seksual.” Mediat duhet të bëjnë dallimin mes lajmit dhe opinionit: lajmi nënkupton informacione të përbëra nga fakte dhe të dhëna, kurse opinionin bart mendim. Në asnjë mënyrë, mendimet e komentet degraduese nuk duhet të postohen në mediat online pasi që janë të ndaluara në bazë të ligjeve të lartpërmendura. Megjithatë, disa media po vazhdojnë të komentojnë pamjen fizike dhe dukjen e grave politikane, madje në disa raste edhe si të papërshtatshme për postet e tyre. As Presidentja e vendit nuk është e përjashtuar nga komentet dhe ofendimet seksiste dhe mizogjiste të shumicës së mediave tona joprofesionale.

Gjatë viteve, kemi hasur në shumë raste të portretizimit degradues të grave e vajzave si objekte seksuale. Shumica e mediave online në Kosovë vazhdimisht përdorin gjuhën paragjyquese, diskriminuese, që rezultojnë në stereotipizimin e grave, edhe pse sipas [Nenit 10](#) të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale e Audiovizuale në Republikën e Kosovës, nuk lejohet “përdorimi i shprehjeve gjuhësore denigruese, me qëllim të lëndimit apo kërcënimit të një individi apo grupi mbi baza etnike, religjioze, gjinore, racore, martesore, moshe, apo paafësisë fizike apo mendore etj.”

Ndërkaq, në bazë të [Nenit 9](#), të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale e Audiovizuale në Republikën e Kosovës “prezantimi i fëmijëve dhe të miturve, programet dhe materialet në të cilat janë të përfshirë fëmijët duhet t’i përmbahen të gjitha ligjeve, rregullave dhe rregulloreve përkatëse mbi transmetimin audio-vizual.” Ndërsa në vendin tonë, fëmijët keqpërdoren në mënyra të ndryshme, nga disa prej mediave tona online, për shembull rasti i tre vjeçarës duke imituar vallëtarën ‘Kallashi’.

RrGGK kërkon nga Komisioni i Pavarur për Media dhe Instituti i Mediave të Kosovës të monitorojnë mediet e Kosovës dhe në bazë të Kodit për Shërbimet Mediale të ndëshkojë me gjobë mediet të cilat shkelin këtë kod dhe standardet e barazisë gjinore në Kosovë.

*Misioni i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK) është të përkrahë, mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave anembanë Kosovës, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, religjionin, moshën, nivelin e arsimimit, orientimin seksual apo aftësitë e kufizuara. RrGGK përmbush misionin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneritetëve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe ofrimit të shërbimeve. Si Rrjet i 89 organizatave të grave nga të gjitha grupet etnike në tërë Kosovën, RrGGK avokon në emër të grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.*

# PRESS

www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000  
Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 •  
info@womensnetwork.org